



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo			CAA
Nr. i prot. Br.prot./Prot.Nr.	2025/ZDP/120	Data: 27.03.2025 Datumi/Data	
Faqe/ Stranica/Pages	2	Kopje/ Kopija/Copy	1
Hyrës/ Dalës/ulazno/out	<input type="checkbox"/>	Brendshëm/ Vntemo/indamol	<input checked="" type="checkbox"/>
			Prishtina/Prishtina/Pristina

12/ZDP/VE/2025
Datë: 27 mars 2025

Në mbështetje të nenit 14.1, 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28, Viti III, datë 4 qershor 2008), ndryshuar me Ligjin nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënese të agjencive të pavarura (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 30, dt 05 shtator 2022), nenit 24 Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe funksionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr. 7, dt 01 mars 2019) dhe në pajtim me Rregulloren Nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (AAC) 05/2019.

Duke marrë në konsideratë Vendimet me nr. 08/ZDP/VE/2019 dt. 31.05.2019, 24/ZDP/VE/2019 dt. 31.07.2019, 26/ZDP/VE/2019 dt. 30.09.2019, 03/ZDP/VE/2020 dt. 30.03.2020, 09/ZDP/VE/2020 dt. 29.09.2020, 05/ZDP/VE/2021 dt. 30.03.2021, 04/ZDP/VE/2022 dt. 30.03.2022, 03/ZDP/VE/2023 dt. 30.03.2023, 07/ZDP/VE/2024 dt. 28.03.2024 për vazhdim të përkohshëm të aprovimit të operatorit të ANP “Adem Jashari”- LKIA sh.a., si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

V E N D I M

- VAZHDOHET** deri më **31 mars 2026**, aprovimi i Operatorit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – LKIA sh.a. si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10, të shtojcës 1 të Rregullosës Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, të ndryshuar.
- OBLIGOHET** subjekti nga pika 1 e këtij Vendimi që gjatë kohës së ofrimit të shërbimeve t’iu përmbahet me përpikëri dispozitave të Rregullosës nr. 4/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, të ndryshuar dhe kërkesave tjera legjislative të sigurisë në fuqi për ofruesit e shërbimeve në tokë për palë të treta.
- Vendimi hyn në fuqi nga data 01 prill 2025.

ARSYETIM

Më datën 16 prill 2019, operatori i Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari” – LKIA sh.a., ka aplikuar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës për vazhdim të aprovimit si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10 të shtojcës 1 të Rregullosës Nr. 4/2011 për Qasjen në Tregun e Shërbimeve në tokë, me ndryshime.

Ngë data e aplikimit deri më tani janë lëshuar për operatorin LKIA sh.a., aprovimet për zgjatje të përkohshme përmes vendimeve si në vijim: Vendimi nr. 08/ZDP/VE/2019 dt. 31 maj 2019, Vendimi nr. 24/ZDP/VE/2019 dt. 31 korrik 2019, Vendimi nr. 26/ZDP/VE/2019 dt. 30 shtator 2019, Vendimi

03/ZDP/VE/2020 dt. 30 mars 2020, Vendimi 09/ZDP/VE/2020 dt. 29 shtator 2020, Vendimi 05/ZDP/VE/2021 dt. 30 mars 2021, Vendimi 04/ZDP/VE/2022 dt. 30 mars 2022, Vendimi 03/ZDP/VE/2023 dt. 30 mars 2023 dhe 07/ZDP/VE/2024 dt. 28 mars 2024. Vendimet e lartpërmendura për zgjatje të përkohshme të aprovimit për LKIA sh.a. janë lëshuar me qëllim që organi menaxhues i aeroportit të krijoj kushtet për hapje të tregut në përputhje me kërkesat rregullore të parapara në Rregulloren 04/2011, të ndryshuar. Gjatë periudhës së vazhdimit të aprovimeve, nga organi menaxhues i ANP "Adem Jashari" është kërkuar krijimi i listës së infrastrukturës së centralizuar për shërbimet në tokë dhe çmimoret përkatëse, si parakushte për krijim e rrethanave për hapjen e tregut për shërbime në tokë për palë të treta.

Drejtori i Përgjithshëm ka marrë konfirmimin nga njësia përgjegjëse për Aerodrome më 24 mars 2025 dhe nga njësia përgjegjëse për Rregullimit Ekonomik të Aviacionit më 20 mars 2025, sipas të cilave konfirmohet, që operatori është subjekt i mbikëqyrjes së rregullt, bazuar në planin vjetor të mbikëqyrjes së sigurisë (annual safety oversight plan) dhe se rrjedhimisht, subjekti në fjalë vazhdon të operojë në përputhje me kërkesat legjislative të sigurisë si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta; dhe respektivisht konfirmimin nga që operatori ka vazhduar të mirëmbajë kritere ekonomike në bazë të të cilave është aprovuar nga AAC si ofrues i shërbimeve në tokë për palë të treta në ANP "Adem Jashari".

Vazhdimi i kohëzgjatjes edhe për një (1) vit bëhet me qëllim të interesit publik të ofrimit të shërbimeve në tokë për palë të treta në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", për kategoritë 1, 2, 3, 4, 5, 6 (përfshirë pastrimin e jashtëm), 9 dhe 10 (të shtojcës 1 të Rregullores) dhe krijim të kushteve për zbatim të normave rregullore në fuqi.

Nga sa u tha më lartë, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, në pajtim me nenin 14.1, 15.1 (d) dhe (f), 69 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, me ndryshime, si dhe nenin 24 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, në përputhje me Rregulloren nr. 04/2011 për qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, siç është plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren (AAC), 05/2019, dhe Vendimeve paraprahe për vazhdim të përkohshëm të aprovimit, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim mbi mjetin juridik: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesë. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të ngrit konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit.


Burim Dinarama
UD. Drejtor i Përgjithshëm

Iu dërgohet:

- Organit menaxhues të ANP "Adem Jashari" LKIA, Vrellë, Komuna e Lipjanit;
- Komitetit për Partneritet Publiko Privat;
- Arkivit të AAC-së.